

Njoftim paralajmërues



Në rrjetet sociale po qarkullon loja “Jonathan Galindo”

Në rrjetet sociale po qarkullon loja e quajtur “Jonathan Galindo”, e cila targeton fëmijët e të rinjtë e moshave 10 – 18 vjeç, duke i çuar drejt vetëvrasjes.

Loja është e ngjashme me Balenën Blu dhe emri i saj përfaqëson një personazh të përshkruar si një njeri i veshur me një maskë qeni “Goofy”. Personazhi “Jonathan Galindo” aktualisht është i paidentifikuar, por profili i parë i përdorur për këtë qëllim është iniciuar nga platforma sociale “TikTok”.

Përdorues anonimë në internet, krijojnë profile duke përdorur emrin “Jonathan Galindo” dhe duke përdorur imazhe të ndryshme të “Cursed Goofy”, më pas iu dërgojnë mesazhe fëmijëve përmes rrjeteve sociale, duke i pyetur nëse dëshirojnë të luajnë një lojë. Nëse personat pranojnë të luajnë, kjo sfidë mund të zgjasë 50 ditë me 50 sfida të ndryshme dhe si përfundim sfida e fundit mund t’i çojë deri në shkaktimin e vetëvrasjes. Nëse ata refuzojnë së komunikuar me personin në fjalë, atëherë ata i kërcënojnë duke ju thënë se do të bëjnë publike informacionin e tyre personal. Loja nis me sfida të lehta dhe në vijim ato ndërlikohen duke bërë që fëmijët të dëmtojnë veten e tyre.

Loja e ngjashme që është aplikuar më përpara, “Balena Blu”, e cila shënoi mbi 130 viktima në të gjithë botën. Shenjat që fëmijët shfaqin janë pagjumësia, veshja e rrobave të gjata për të mbuluar dëmtimet trupore, si dhe mosushqyerja.

Tregohuni vigjilentë dhe monitoroni vazhdimisht sjelljen e fëmijës, pajisjet kompjuterike dhe aparatet telefonike smart të fëmijës. Çdo rast i dyshimtë duhet të raportohet pranë Policisë së Shtetit.